



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarje të subvencioneve për projektet të OJQ-ve (klubet sportive) që veprojnë në Komunën e Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Shahadije Ibrahim, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
3. Eron Syla, nga OJQ-të, anëtar
4. Florim Budakova, nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit, anëtar
5. Albulena Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare
6. Shehide Sopa, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtare rezerv

**Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për ndarje të subvencioneve për OJQ (Klubet Sportive) që veprojnë në Komunën e Lipjanit, që kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.1-453-17339 të datës 31.03.2021, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 1-453-21315
Lipjan, më 20.04.2021.

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

